

INSTITUTI PËR STUDIME TË AVANCUARA - GAP

RAPORTI I AUDITORËVE TË PAVARUR DHE PASQYRAT FINANCIARE

Me dhe për vitin që përfundoi më 31 dhjetor 2021

Përbajtja

RAPORT I AUDITORËVE TË PAVARUR	3
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR.....	5
PASQYRA E TË ARDHURAVE	6
PASQYRA E RRJEDHËS SË PARASË.....	7
1. Informata të përgjithshme	8
2. Baza e përgatitjes	8
3. Përbledhja e politikave të rëndësishme kontabël.....	9
4. Pajisjet e zyrës.....	10
5. Paraja dhe ekuivalentët e parasë.....	10
6. Llogaritë e Arkëtueshme	10
7. Llogaritë e pagueshme	11
8. Të ardhurat e shtyra	11
9. Të ardhurat nga donacionet.....	11
10. Shpenzimet e Pagave	12
11. Shpenzimet e programit dhe administrative	12
12. Detyrimet kontigjente dhe zotimet	12
13. Ngjarje pas datës së raportimit	12

RAPORT I AUDITORËVE TË PAVARUR

Për: Menaxhmentin e Instituti për Studime të Avancuara - GAP

Opioni

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Instituti për Studime të Avancuara – GAP ("Organizata"), të cilat përbëhen nga pasqyra e pozicionit finanziar me 31 dhjetor 2021 dhe pasqyra e të ardhurave, pasqyra e ndryshimeve në fonde dhe pasqyra e rrjedhës së parasë për vitin që përfundoi në atë datë, dhe shënimet e pasqyrave financiare, përfshirë politikat domethënëse të kontabilitetit.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare të Organizatës për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2021 janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në pajtueshmëri me kërkesat për raportim finanziar të përshkruar në shënimin 2 dhe kërkesave sipas ligjit nr. 06/L-043 për lirinë e asociimit në organizatat joqeveritare.

Baza për opinionin

Ne kemi kryer auditimin në pajtueshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar më tutje në seksionin *Përgjegjësitë e auditorit në auditimin e pasqyrave financiare* e këtij raporti.

Ne jemi të pavarur nga organizata në pajtueshmëri me kërkesat etike që janë relevante gjatë auditimit tonë të pasqyrave financiare në Kosovë, dhe kemi përmbrushur përgjegjësitë tona etike në pajtueshmëri me këto kërkesa. Ne besojmë se evidencat e përfituarë të auditimit janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të na ofruar një bazë për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e menaxhmentit dhe personave të ngarkuar me qeverisjen për pasqyrat financiare Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare në pajtueshmëri me dispozitat e raportimit finanziar të organizatës dhe ligjeve relevante në Kosovë dhe për kontolle të tillë të cilat menaxhmenti përcakton se janë të domosdoshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së organizatës të vijojë sipas hipotezës së vijimësisë, duke shpalosur, nëse është e zbatueshme, çështjet lidhur me hipotezën e vijimësisë dhe duke përdorur bazën e kontabilitetit bazuar në vijimësi përvëç nëse menaxhmenti ka për qëllim të likuidojë ose të ndërpresë aktivitetet e organizatës, ose nuk ka ndonjë alternativë tjetër përvëç të veprojë në këtë mënyrë.

Personat e ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit finanziar të organizatës.

Përgjegjësitë e auditorit në auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë të përfitojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përbajnjë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të japid një raport të auditorit që përfshinë opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është nivel i lartë i sigurisë, por nuk është garancion se auditimi i kryer sipas SNA gjithmonë do të zbulojë anomali materiale kur ekzistojnë ato. Anomalitë mund të paraqiten nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen që janë materiale nëse, individualisht ose të grumbulluara, ato mund të ndikojnë në mënyrë të arsyeshme në vendimin që marrin përdoruesit bazuar në këto pasqyra financiare. Si pjesë e auditimit në pajtueshmëri me SNA, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional përgjatë tërë auditimit.

Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtimit ose gabimit, projektojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit si përgjigje ndaj këtyre rreziqeve dhe përfitojmë evidenca të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të na ofruar bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të anomalive materiale për shkak të mashtimit është më i lartë se ai i shkaktuar nga gabimet, pasi që mashtimi mund të përfshijë marrëveshjet e fshehta, falsifikimin, lënjen anash me qëllim, keqinterpretimin ose anashkalimin e kontrolleve.
- Përfitojmë njohuri mbi kontrolllet e brendshme që janë relevante për auditimin në mënyrë që të projektojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme për ato rrethana, por jo me qëllim të japid një opinion mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të organizatës.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të përdorura të kontabilitetit dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël dhe shpalosjeve përkatëse nga menaxhmenti.
- Përfundojmë mbi përshtatshmërinë e përdorimit të hipotezës së vijimësisë nga ana e menaxhmentit dhe bazuar nga evidenca e përfthuar e auditimit, nëse ekziston ndonjë pasiguri materiale lidhur me ngjarjet ose kushtet që mund të hedhin dyshim domethënës mbi aftësinë e organizatës për të vijuar ekzistencën. Nëse arrijmë në përfundim se ekziston një pasiguri materiale, nga ne kërkohet të térheqim vëmendjen në reportin tonë të auditorit në shpalosjen përkatëse të pasqyrave financiare ose, nëse një shpalosje e tillë është e pamjaftueshme, ta modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona janë të bazuara në evidencat e auditimit të përfthuara deri në datën e reportit të auditorit. Mirëpo, ngjarjet dhe kushtet e ardhshme mund të shkaktojnë që organizata të mos vijojë aktivitetet e saj.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, në mes tjerash edhe lidhur me fushëveprimin e planifikuar, kohën e auditimit dhe gjetjet domethënëse të auditimit, përfshirë çfarëdo mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm të identikuara gjatë auditimit tonë.

Lulzim Krasniqi,
Auditor ligjor

Quatra Audit Int. L.L.C.
Prishtinë

24 mars 2022



INSTITUTI PËR STUDIME TË AVANCUARA - GAP

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR

Me 31 dhjetor 2021

(të gjitha shumat në Euro)

	<i>Shënimet</i>	Me 31 dhjetor 2021	Me 31 dhjetor 2020
Pasuritë			
I. Pasuritë qarkulluese			
Paraja në dorë dhe në banka	5	210,710	265,659
Llogaritë e Arkëtueshme	6	-	27,645
Total Pasuritë qarkulluese (I)		210,710	293,304
II. Pasuritë jo-qarkulluese			
Pajisjet e zyres	4	4,594	8,661
Total Pasuritë jo-qarkulluese (II)		4,594	8,661
Total Pasuritë (I+II)		215,304	301,965
Detyrimet dhe Bilanci i fondevë			
III. Bilanci i Fondevë			
Bilanci në fillim		-	-
Suficiti i viti		-	-
Total Bilanci i fondevë (III)		-	-
IV. Detyrimet afatshkurtra			
Llogaritë e pagueshme	7	4,040	4,479
Të hyrat e shtyra	8	211,264	297,486
Total detyrimet afatshkurtëra (IV)		215,304	301,965
Total detyrimet dhe bilanci i fondevë (III+IV)		215,304	301,965

Këto pasqyra financiare janë aprovuar për publikim nga Bordi i Drejtorëve me 2 mars 2022 dhe u nënshkruan në emër të tij nga:



Blendi Hasaj
Drejtor Ekzekutiv



Nita Tafarshiku
Menaxhere e financave

INSTITUTI PËR STUDIME TË AVANCUARA - GAP**PASQYRA E TË ARDHURAVE**

Për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2021

(të gjitha shumat në Euro)

		Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2021	Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2020
I. Donacionet			
Të ardhurat nga donacionet	9	249,506	277,824
Total (I)		249,506	277,824
II. Shpenzimet			
Shpenzimet e Pagave	10	(173,036)	(194,091)
Shpenzimet e programit dhe administrative	11	(71,303)	(78,786)
Shpenzimet e zhvlerësimit	4	(5,167)	(4,947)
Total (II)		(249,506)	(277,824)
Suficiti/(Deficiti) i vitit (I+II)		-	-

INSTITUTI PËR STUDIME TË AVANCUARA - GAP

PASQYRA E RRJEDHËS SË PARASË

Për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2021
(të gjitha shumat në Euro)

<i>Shënimet</i>	Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2021	Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2020
Fitimi neto për vitin përparratatimit mbi fitim		
<i>Rregullimet për:</i>		
Zhvlerësimin	4	5,167
Ndryshimet në kapitalin punues		
(Rritja) në të arkëtueshmet		27,645
Rritja në të pagueshmet tregtare dhe të tjera	6	(439)
Rritja në të ardhurat e shtyera	7	(86,222)
		<u>103,366</u>
	(53,849)	80,868
Tatimi në fitim i paguar		
Paraja neto e përdorur për aktivitetet operative		(53,849)
		80,868
Aktivitetet investive		
Shtesat në pasuritë fikse		(1,100)
Paraja neto e përdorur në aktivitetet investuese		(1,100)
		(601)
Aktivitetet financuese		-
Paraja neto e përdorur në aktivitetet financuese		-
Rritja/(Zvogëlimi) në para dhe ekuivalentët e saj gjatë vitit		(54,949)
Paraja dhe ekuivalentët e saj, në fillim të vitit	5	265,659
Paraja dhe ekuivalentët e saj, në fund të vitit	5	210,710
		265,659

INSTITUTI PËR STUDIME TË AVANCUARA - GAP

SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE

Për vitin që përfundoj me 31 dhjetor 2021

(të gjitha shumat në Euro)

PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KRYESORE TË KONTABILITETIT DHE INFORMATAT E PËRGJITHSHME

1. Informata të përgjithshme

Instituti për Studime të Avancuara GAP është e regjistruar si organizatë jo-qeveritare dhe jo-fitimprurëse sipas Ligjit 03/L-134 mbi Lirinë e Asocimit te Organizatave Jo-Qeveritare, me 17 Gusht 2007 me zyre qendrore në Prishtinë.

Instituti për Studime të Avancuara GAP është një Think Tank i Kosovës qëllimi kryesor i të cilit është të tërheq profesionistë për të krijuar një hulumtim profesional dhe ambient të zhvilluar që haset në institucionë të ngashme në shtetet perëndimore.

Kjo do të përfshijë sigurimin e kosovarëve me një mundësi për hulumtim të zhvilluar dhe për të implementuar projekte që do të forconin shoqërinë kosovare. Prioritet për këtë Institut është mobilizimi i profesionistëve në adresimin e sfidave ekonomike, politike dhe sociale të vendit. Qëllimet kryesore të GAP-it janë të mbushë zbrazëtitë në mes të qeverisë dhe qytetarëve, si dhe të mbushë zbrazëtitë në mes të problemeve dhe zgjidhjeve.

2. Baza e përgatitjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 06/L-043 Për Lirinë e Asocimit në Organizatat Jo-qeveritare me qëllim të raportimit në Zyrën e Rregullatorit të OJQ-ve.

Të hyrat nga grantet njihen kur fitohen në vend se kur pranohen dhe shpenzimet njihen kur ndodhin në vend se kur paguhen.

Perveç kësaj, detyrimi i shtyrë i grantit, parapagimet dhe detyrimet e tjera regjistrohen sipas bazës akruale të kontabilitetit. Politikat e rëndësishme të kontabilitetit janë përshkruar më poshtë.

INSTITUTI PËR STUDIME TË AVANCUARA - GAP

SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE

Për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2020

(të gjitha shumat në Euro)

3. Përbledhja e politikave të rëndësishme kontabël

3.1. Paraja dhe ekuivalentët e parasë

Paraja dhe ekuivalentët e parasë përfshijnë paranë në arkë dhe paranë e pakushtëzuar me bankat ose depozitat me afat maturimi më pak se tre muaj.

3.2. Njohja e të ardhurave

Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të shumës së arkëtar ose për t'u arkëtar dhe përfaqëson vetëm shumën e arkëtueshme nga donatorët në lidhje me listën e pagave, shpenzimet operative dhe shpenzimet tjera të shkaktuara.

3.3. Transaksionet në valuta të huaja

Transaksionet në valuta të ndryshme nga valuta funksionale (valutë të huaj) regjistrohen në normat e këmbimit që mbizotërojnë në datat e transaksioneve. Në çdo datë raportimi, zërat monetare të shprehur në valutë të huaj konvertohen në normat mbizotëruese në datën e raportimit. Zërat monetarë që maten me kosto historike në valutë të huaj nuk ripërkthehen. Diferencat e këmbimit që rrjedhin nga zërat monetare, janë të përfshira në fitimin dhe humbjen e periudhës në të cilën ato lindin.

3.4. Përfitimet e punonjësve

Organizata nuk ka përgjegjësi shtesë për pensionet e punëtorëve përveç pagesës së kontributeve pensionale në Trustin e Kursimeve Pensionale të Kosovës.

3.5. Kontigjencat dhe provisionet

Detyrimet kontingjente nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato shpalosen përveç nëse mundësia e rrjedhës se mjeteve që trupëzojnë përfitime ekonomike është e largët. Një pasuri kontigjente nuk njihet në pasqyrat financiare por shpaloset kur hyrja e përfitimeve ekonomike është e mundshme. Një provizion është i njohur atëherë kur Organizata ka një detyrim të pranishëm (ligjor ose strukturor) si rezultat i një ngjarje të kaluar dhe është e mundshme që një rrjedhje e burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike do të kërkohen për të shlyer detyrimin, dhe një vlerësim i besueshëm mund t'i bëhet shumës së detyrimit.

3.6. Gjykime kritike kontabël dhe burimet kryesore të pasigurisë në vlerësim

Në procesin e zbatimit të politikave kontabël të Organizatës, të cilat janë të përshkruara më sipër, menaxhmenti nuk ka bërë asnjë gjykim i cili ka efekte të rëndësishme në shumat e njohura në pasqyrat financiare

INSTITUTI PËR STUDIME TË AVANCUARA - GAP

SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE

Për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2020

(të gjitha shumat në Euro)

4. Pajisjet e zyrës

Kosto

Bilanci me 31 dhjetor 2019

Shtesat

Shlyerjet

Bilanci me 31 dhjetor 2020

Shtesat

Shlyerjet

Bilanci me 31 dhjetor 2021

Zhvlerwimi i Akumuluar

Bilanci me 31 dhjetor 2019

Zhvlerësimi i viti

Shlyerjet

Bilanci me 31 dhjetor 2020

Zhvlerësimi i viti

Shlyerjet

Bilanci me 31 dhjetor 2021

Vlera neto në libra me 31 dhjetor 2020

Vlera neto në libra me 31 dhjetor 2021

Pajisjet e Zyres

Total

	Pajisjet e Zyres	Total
Bilanci me 31 dhjetor 2019	41,235	41,235
Shtesat	601	601
Shlyerjet	-	-
Bilanci me 31 dhjetor 2020	41,836	41,836
Shtesat	1,100	1,100
Shlyerjet	(31,487)	(31,487)
Bilanci me 31 dhjetor 2021	11,449	11,449

5. Paraja dhe ekuivalentët e parasë

Shumat e mëposhtme përbëjnë gjendjen më 31 dhjetor 2021 dhe 2020:

Me 31 dhjetor 2021

Me 31 dhjetor 2020

TEB Euro

210,533

265,354

TEB Dollar

77

77

Paraja në dorë

101

227

Total

210,710

265,659

6. Llogaritë e Arkëtueshme

Me 31 dhjetor 2021

Me 31 dhjetor 2020

The Kosovo Glocal (Kosovo 2.0.)

-

27,645

Total

-

27,645

INSTITUTI PËR STUDIME TË AVANCUARA - GAP

SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE

Për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2020

(të gjitha shumat në Euro)

7. Llogaritë e pagueshme

Shumat e mëposhtme përbëjnë gjendjen më 31 dhjetor 2021 dhe 2020:

	Me 31 dhjetor 2021	Me 31 dhjetor 2020
Llogaritë e pagueshme	1,410	1,493
Tatimet dhe kontributet	2,522	2,877
Tatimi në qira	109	109
Total	4,040	4,479

8. Të ardhurat e shtyra

Të ardhurat e shtyra janë të ardhurat e pranuara por ende të panjohura përmes pasqyrës së të ardhurave. Këto të ardhura njihen në momentin që shfrytëzohen apo shpenzohen.

	Me 31 dhjetor 2021	Me 31 dhjetor 2020
Të ardhurat e shtyra	211,264	297,486
Total	211,264	297,486

9. Të ardhurat nga donacionet

	Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2021	Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2020
SIDA	85,700	86,174
Rockefeller Brothers Fund	39,829	39,490
OSIFE	8,292	36,281
National Endowment for Democracy	41,662	33,729
EU	33,506	27,645
KFOS	-	21,140
US Embassy	-	15,701
Main/Other	9,451	6,302
MATRA	-	5,771
UNDP	31,067	5,591
Total	249,506	277,824

* Në të hyrat nga donacionet për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2020 është përfshirë dhe një e hyrë akruale e cila ka të bëjë me projektin "Innovation for resilient media and citizen engagement" me partnerin implementues Organizatën The Kosovo Glocal (Kosovo 2.0.) e cila është udhëheqëse e këtij Konzorciumi, projekt ky i financuar nga Komisioni Evropian. Për periudhën që përfundon më 31 dhjetor 2020, Organizata kishte kryer shpenzime në shumën prej 27,645 Euro për të cilat ajo raportoi tek Partneri i Konsorciumit, Kosovo Glocal (Kosovo 2.0.) dhe ka marr këto këto fonde gjatë vitit 2021.

INSTITUTI PËR STUDIME TË AVANCUARA - GAP

SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE

Për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2020

(të gjitha shumat në Euro)

10. Shpenzimet e Pagave

Shpenzimi i pagave për vitin 2021 ka vlerën e 173,036 Euro (2020: 194,091 Euro). Organizata ka ndalur tatimin në pagë dhe ka paguar kontributet pensionale bazuar në ligjin mbi të ardhurat personale për të gjithë stafin e angazhuar gjatë periudhës raportuese.

11. Shpenzimet e programit dhe administrative

	Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2021	Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2020
Qiraja dhe tatimi në qira	14,505	14,505
Kostot e dizajnit	10,382	8,630
Tarifa profesionale	2,516	7,380
Reklama	1,398	3,267
Mirëmbajtja e webfaqes dhe zyrës	6,767	7,125
Tryeza e rrumbullakët	4,017	6,553
Shpenzimet e udhëtimit	3,623	5,352
Shërbimet e përkthimit	4,332	4,453
Kostot e printimit	1,730	1,808
Komunalitë	547	850
Komunikimit	2,004	1,586
Furnizimet e zyrës	1,564	1,116
Tarifat bankare	354	961
Shpenzimet e takimit për projekt	1,064	533
Kontrata për Hulumtim	8,941	8,520
Tjera	7,560	6,146
Total	71,303	78,786

12. Detyrimet kontigjente dhe zotimet

Zotimet e qirasë operative:

Me 31 dhjetor	2021	2020
Pagesa brenda një viti	4,835	4,835
Pagesa më shumë se një vit ose më pak se pesë vite	-	-

13. Ngjarje pas datës së raportimit

Nuk ka ngjarje tjera që pasojnë datën e raportimit që kërkojnë dhënien e informacioneve shpjeguese në pasqyrat financiare të Organizatës.